

VENDIM
Nr. 690, datë 29.7.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 18.6.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR
KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 555, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Numrat rendorë 4 dhe 10, në ndarjen I – “Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

...

“10. Koordinator në Sekretariatit Teknik (Drejtorinë), sektori i qeverisjes së mirë dhe administrimit publik, në Kryeministri.”.

2. Pas numrit rendor 38, në nëndarjen II - “Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm” shtohen pozicionet, si më poshtë vijon:

“39. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës.

40. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Fier.

41. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

42. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër.

43. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

44. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

45. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë.

46. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat.

47. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Lezhë.

48. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

49. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

50. Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama